



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ANTIKORRUPSIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE ANTIKORRUPSION
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT STRATEGJIK NË FUSHËN
ANTI-KORRUPSION

Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit janar-qershor 2023, të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023

1. Titulli i draft aktit: Raporti i monitorimit për periudhën janar-qershor 2023, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve - Konsultimi i parë (drafti 1) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 8 ditë pune (nga data 20 korrik 2023 - 31 korrik 2022). Gjatë kësaj periudhe, institucioneve zbatuese iu është dërguar drafti i raportit për komente të mundshme dhe vlerësime nga ana e tyre. Konsultimi i dytë (drafti 2) ka zgjatur 9 ditë pune (nga data 04 gusht 2023 - 16 gusht 2022) dhe ka qenë i hapur në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë. Publikimi është bërë në gusht 2023, në menunë: prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia kundër korrupsionit/raporte monitorimi në www.drejtësia.gov.al dhe ka qenë i hapur deri në datën 18 shtator 2023.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë draft raport janë si vijon:

- Dërguar via email institucioneve përgjegjëse e zbatuese të PV SNKK dhe Departamentit në KM/ dërguar draft - raporti i hartuar; dërguar formati i raportimit (për masat dhe aktivitetet); dërguar formati i raportimit (për treguesit e performancës me vlera vjetore), për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara.

- Komunikimi i drejtpërdrejtë via email për çdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash, informacioni i munguar dhe komente të ardhura nga data 20.07.2022 - 18.09.2023.

- Faqja zyrtare e MD-së, www.drejtësia.gov.al

- Takim i realizuar është në datë 18.09.2023 - tryezë ndërinstitucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes A – parandaluese, B – ndëshkuese, Qasjes C- ndërgjegjësuese).

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike në stafin teknik të drejtorisë antikorrupsion rovena.pregja@drejtesia.gov.al dhe artens.lazaj@drejtesia.gov.al .
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezën e konsultimit të zhvilluar në MD (online).

Gjithashtu Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit shpalli për konsultim publik draft raportin e monitorimit janar-qershor 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023 edhe për OSHC-të, duke pritur komente, mendime dhe sugjerime nga ta brenda datës 18 shtator 2023, në adresën artens.lazaj@drejtesia.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV SNKK dhe të grupeve të interesit në fushën antikorrupsion.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (i pranuar/ i pranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi
Kërkohet plotësim informacioni për vlerat e treguesve të performancës të parashikuara për AAPSK	AAPSK	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport dhe në aneksin e indikatorëve.
Kërkohet plotësim informacioni për numrin e kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit dhe numrin total të kallëzimeve penale të kryera pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për veprat penale të korrupsionit	PP	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport.
Kërkohet plotësim informacioni për institucionet e varësisë që kanë miratuar një Plan Integriteti	MBZHR	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport.
Kërkohet plotësim raportimi për treguesit e performancës A.7.b, A.7.c	MFE	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në

dhe A.7.d të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë			raport dhe anekset shoqëruese të tij.
Kërkohet informacion shtesë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi numrin e autoriteve publike që kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare, Programin e Transparencës, gjatë kësaj periudhe raportuese.	KDIMDHP	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport dhe anekset shoqëruese.
Kërkohet plotësim informacioni mbi masën A.10 të aneksit të masave dhe aktiviteteve.	MD, statistikat	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport mbi platformën e re elektronike.
Kërkohet plotësim informacioni mbi treguesit e performancës dhe aneksin e masave dhe aktiviteteve.	APP	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport dhe në anekset shoqëruese.
Kërkohet plotësim informacioni mbi baza të reja të dhënash shtetërore, të Policisë së Shtetit, gjatë kësaj periudhe raportuese.	PSH	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit në aneksin e treguesve të performancës.
Nevojitet plotësimi i të dhënave të treguesve të performancës, mbi arrijet institucionale për këtë periudhë raportuese.	SPAK	I pranuar	Informacioni i dërguar është bërë pjesë e strukturës së raportit të monitorimit dhe matjes së treguesve.
Kërkohet plotësimi i të dhënave për aneksin e masave dhe aktiviteteve dhe vlerat e treguesve të performancës	KQZ	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport.